

## Vend vakant për pozicionin “Punonjës pastrimi”

AKSIK shpall vend vakant për pozicionin “Punonjës pastrimi”, në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

### KËRKESAT E POSAÇME QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI PËR POZICIONIN “PUNONJËS PASTRIMI”

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- c - Të plotësojnë kriteret për t’u pajisur me CSP sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”.

### KUSHTE TË PËRGJITHSHME

Marrëdhënia e punës me Autoritetin Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar rregullohet nga dispozitat e ligjit nr.7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës”, i ndryshuar.

Klasa e pagës për pozicionin “Punonjës pastrimi”, është I.

Kandidatët duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur e punuar në grup.

Aplikimi duhet të dorëzohet nga data 09.06.2026 deri më 16.06.2026.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar.
- b - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- c - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- d - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- e - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, duhet të dorëzohen pranë institucionit ose me anë të postës zyrtare, në adresën: Rr.”Ibrahim Rugova”, 1019, Tiranë.

Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 16.06.2026.